



Dep.	DPKI	Nr. Prot.	03-02/1203/18
Nr. l.faq.	02	Data	19.04.2018
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.04.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-276/18, për z. Ismet Azemi, Anëtar i Anëtar i Këshillit Drejtues në Teatrin Kombëtar të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ismet Azemi, Anëtar i Këshillit Drejtues në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe njëkohësisht Kryetar i Sindikatës së Teatrit Kombëtar të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Azemi është bindur me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej dhe për veprimet që duhet të ndërmerre për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit..

Zyrtari i lartë z. Azemi është deklaruar se do të ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas kërkesës së Agjencisë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/1067/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Sindikatës së Teatrit Kombëtar të Kosovës. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Mirëpo, gjatë ushtrimit të funksionit publik, eventualisht mund të shfaqet ndonjë konflikt “rast për rast” të interesit, por në situata të tilla zyrtari i lartë është i obliguar të veproj konform nenit 13 (paragrafi 1,2,3) të Ligjit nr.04/L-051 për PKI në të cilin shprehimisht thuhet:

*1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinë paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.*

*2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.*

*3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në njëvendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

